



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

VENDIM

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 01, PARAQITUR NË KQZ
NË DATËN 21.05.2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 21.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Partia Bindja Demokratike

OBJEKT: Kundërshtimi i vendimit nr.4, datë 18.05.2019 të KZAZ-së nr.64 Berat "Për mosregjistrimin e Kandidatit Kryetar të Bashkisë Berat z. Pavlo Shkarpa.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", neni 129, pika 1, 3, germa (a) dhe neni 126, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Subjekti zgjedhor Partia Bindja Demokratike, ka depozituar pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr.01 regj, datë 21.05.2019.



Në mbledhjen e datës 21.05.2019, ora 19:00 pas relatimit të z. Denar Biba, dhe diskutimit të përfaqësuesve të partive politike, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 01 i plotëson elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130 dhe në mbështetje të nenit 129 pika 3, germa "a", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Kërkesa Ankimore duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 21, pika 1, nenin 126, pika 2, nenin 129, pika 1, 3, germa "a", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 01, datë 21.05.2019, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Bindja Demokratike.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 23.05.2019, në orën 11:00.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

